



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 329/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrin (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së tubimit publik pa paralajmërim, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

## VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrin (PAI), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI dega në Ferizaj, më të cilën theksuhet se me datën 22.10.2013 në ora 18:30, në Ferizaj në lagjen “Asim Vokshi” subjekti politik PDAK ka mbajtur fushatë zgjedhore pa u lajmëruar Policia e Kosovës dhe KKZ-ja në Ferizaj. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës menjëherë ka lajmëruar KKZ-në në Ferizaj, policinë dhe Demokracinë në Veprim.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDAK më kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik brenda afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDAK ku mes të tjera shkaktohet se këto janë vetëm shpifje pasi që PDAK është konsultuar me KKZ-në që tubimet publike të lajmërohen por jo edhe tubimet individuale dhe familjare dhe se pretendimet e subjektit politik PAI se PDAK me datën 22.10.2013 ka mbajtur tubim publik nuk janë te vërteta dhe janë shpikje pasi që për tubimet e PDAK-së gjithëher kanë qenë të njoftuar në polici dhe KKZ. Subjekti politik PDAK përgjigjet më ankesë i ka bashkangjitur si dëshmi formularët e njoftimeve përmes mbajtjen e mëhershme të tubimeve publike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore se anëtarët e subjekti politik PDAK kanë mbajtur tubim publik pa u lajmëruar dhe pa e informuar organet kompetente, nuk qëndrojnë ngase nuk janë ofruar dëshmi përmes pretendimet siç theksohen

në ankesë andaj pretendimet tilla për pa i mbështetur në prova bindëse u vlerësuan si të pabazuar dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

Anr. 329/2013 më datën 25.10.2013



Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat përiapelin, sepse vendimët e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.